



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.28, datë 27.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT 7 - 8 KATE, ME FUNKSION TREGTI DHE SHËRBIME”,
ME VENDNDODHJE NË RR. “JORDAN MISJA”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Rreli – S” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Objekt 7 - 8 kate, me funksion tregti dhe shërbime”, me vendndodhje në Rr. “Jordan Misja”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Rreli – S” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

